



Drejtoria për Arsim

Odeljenje za Obrazovanje
Department for Education

Raport tremujor i punës

Janar, Shkurt, Mars (2023)



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC

Drejtoria për Arsim

Odeljenje za Obrazovanje



-IV- Nr. l prot. **883** Më Dt. **05.04.2023**
Br. prot. RAHOVEC - ORAHOVAC

Gjatë tre muajve të parë të vitit 2023 në kuadër të DKA-së u realizuan një varg punësh dhe aktivitete, të cilat ishin të parapara të zhvilloheshin në tremujorin e parë të Planit Vjetor të Punës për vitin 2023. Këto aktivitete të zhvilluara gjatë kësaj periudhe po i paraqesim të shkruara sipas muajve, siç vijon:

Muaji Janar

Në javën e parë të këtij muaji kanë vazhduar punimet në projektin e riparimeve të brendshme në shkollën "Bekim Sylka" dhe paralelisht me këto, kanë vazhduar punimet edhe në efikasitet. Punimet poashtu kanë vazhduar edhe në projektin e ndërtimit të objektit të ri të Shfmu "Hamëz Thaçi" në Xërxë.

Mbajtëm një takim me stafin e DKA-së në të cilin diskutuam për realizimin e planit vjetor të punës për vitin 2023. Kemi vazhduar me përgatitjet e duhura të paramasave për 2 projekte; projektin e furnizimit të shkollave me pako pedagogjike dhe projektin e furnizimit të bibliotekave të shkollave me libra. Pas pushimit me rastin e festës së Vitit të Ri, më 4 janar rifilloi mësimi në të gjitha shkollat dhe procesi mësimor u zhvillua normalisht. Publikuam raportin vjetor të punës së DKA-së për vitin 2022. Mbajtëm një takim me Aktivat Profesionale të DKA-së në të cilin diskutuam për finalizimin e Pakos Pedagogjike. Mbajtëm një takim në Shkollën Profesionale dhe poashtu një takim tjetër përgatitor me Këshillin Organizues për Manifestimet e Flakës së Janarit. Mësimi në të gjitha shkollat dhe procesi mësimor u zhvillua normalisht. Përgatitëm Planin Tremujor të punës së DKA-së për vitin 2023. Kemi filluar me procedurën e prokurimit për projektin e furnizimit të bibliotekave të shkollave me libra. Mbajtëm një takim me zyrtarët e divizionit për infrastrukturë në MASHT për fillimin e zbatimit të 2 projekteve nga niveli qendror, ai i çerdhes për fëmijë në qytet dhe projekti për ndërtimin e objektit të shkollës në Pastasel. Vizituam shkollën "Bajram Curri" në Krushë të Madhe. Mësimi në të gjitha shkollat përfundoi për gjysmëvjetorin e parë dhe gjysmëvjetori i dytë do të fillojë më 6 shkurt 2023. Nga AME kemi marrë pëlqimin për mbrojtjen nga zjarri për objektin e ri të çerdhes në Krushë të Madhe.

Muaji Shkurt

Kanë vazhduar punimet në përfundimin e projektit të riparimeve të brendshme në shkollën “Bekim Sylka”, ku është bërë shtruarja e dysHEMEVE me epoksid dhe ka vazhduar lYerja e fasadës së mureve të brendshme. Punimet poashtu kanë vazhduar edhe në projektin e ndërtimit të në objektit të ri të aneksit në Shfmu “Katër Dëshmorët. Punimet kanë vazhduar edhe në projektin e riparimeve të NYJEVE sanitare të shkollës në fshatin Sapniq. Kemi nisur procedurën e prokurimit për projektin Furnizimi i shkollave me Pakon Pedagogjike.

Mësimi në të gjitha shkollat për gjysmëvjetorin e dytë filloi sot më 6 shkurt 2023, pas pushimit një javor. Kemi punuar në përgatitjen e paramasave për fillimin e projektit për furnizimin e shkollave me mjete dhe pajisje laboratorike. Mbajtëm takim me drejtorët e shkollave, koordinatorët e cilësisë dhe kryetarët e Këshillave Drejtuese të Shkollave. Më 11 shkurt mbajtëm Garën Komunale të Fizikanëve të Rinj, me nxënësit e klasave 9. 10, 11 dhe 12. Gjatë këtij muaji kanë përfunduar punimet në projektin e riparimeve të NYJEVE sanitare të shkollës në fshatin Sapniq. Mbajtëm edhe disa aktivitete garuese e kulturore me rastin e festës së 17 shkurtit – Ditës së Pavarësisë së Kosovës.

Mbajtëm një takim me përfaqësues të QPS-së, Drejtorisë së Shëndetësisë, OJQ-të dhe me Shoqatën Down Syndrome Kosova për koordinimin e aktiviteteve ndërmjet tyre për përkujdesjen ndaj fëmijëve me nevoja të veçanta. I dërguam për të marrë pjesë në Garën Shtetërore të Fizikanëve të Rinj, nxënësit fitues të Garës Komunale. Punime ka patur edhe në disa projekte të efijencës në shkolla dhe kemi punuar në përgatitjen e paramasave të projektit të riparimeve në shkolla.

Muaji Mars

U mbajtën ligjërata vetëdijësuese për sigurinë në komunikacion në bashkëpunim me policinë. Kemi bërë përgatitje për festën e 7 marsit – Ditës së Mësuesit. Me rastin e 7 Marsit – Ditës së Mësuesit dhe Shkollës së Parë Shqipe, mbajtëm një program festiv me mësimdhënësit dhe nxënësit e të gjitha shkollave. Kanë vazhduar të zhvillohen punime në projektin e ndërtimit të objektit të ri të aneksit në Shfmu “Katër Dëshmorët”, ku janë ndërtuar muret e katit të parë. Punimet kanë filluar edhe në projektin e zbatimit të masave të efijencës së energjisë në objektin e Shfmu “Dëshmorët e Zatriqit” në Zatriq.

Kemi punuar në përgatitjen e paramasave të projektit të riparimeve në shkolla dhe kemi nisur procedurën për këtë projekt, ndërkohë që së bashku me drejtorinë e administratës nisëm procedurën për projektin “Mirëmbajtja dhe rregullimi i hapësirave të jashtme dhe të brendshme të objekteve publike”. U mbajtën ligjërata vetëdijësuese për sigurinë në komunikacion dhe për ndikimin negativ të lëndëve narkotike në bashkëpunim me policinë. Së bashku me menaxherin e projektit dhe inxhinierët, kemi vizituar punishtet ku po vazhdojnë punimet në projektin e ndërtimit të objektit të ri të aneksit në Shfmu “Katër Dëshmorët”, dhe në projektin e ndërtimit të objektit të Shfmu “Hamëz Thaçi”. Punimet kanë vazhduar edhe në projektin e zbatimit të masave të efijencës së energjisë në objektin e Shfmu “Dëshmorët e

Zatriqit” në Zatriq, ku javën e tretë të muajit mars janë montuar dritaret e reja dhe u zhvilluan punë në vendin e vendosjes së kalldajës. Patëm një takim me Kolegjiunin për Arsim në kuadër të AKK-së dhe realizuam një vizitë në shkollën e fshatit Sapniq. Dorëzuam një kërkesë në MASHTI për pajisjen e IAAP-së me tri kabinete, në kuadër të thirrjes që kishte bërë MASHTI.

Avni Morina

Drejtore i DKA-së